



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 243/5 Prot

Tiranë, më 12.06.2020

V E N D I M

Nr. 39, datë 12.06.2020

“Mbi verifikimin e zbatimit të ligjshmërisë në procesin e rikthimit të nëpunësit ** në pozicionin e mëparshëm, pas përfundimit të afatit të transferimit të përkohshëm”***

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në pikën 1, të nenit 11, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, si dhe Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, pas shqyrtimit të materialit të përgatitur dhe propozimit të paraqitur prej Drejtorisë së Përgjithshme të Inspektimit dhe Mbikëqyrjes, në përfundim të verifikimit paraprak të informacionit të marrë nga nëpunësi *****,

VËREJ SE:

Nëpërmjet kërkesës së regjistruar pranë Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, me nr. 243 prot., datë 02.03.2020, kërkuesi ***** ka ngritur pretendimin se njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, duke mos zbatuar vendimin e njësisë përgjegjëse (DAP), për rikthimin e tij në pozicionin e mëparshëm, në përfundim të periudhës së transferimit të përkohshëm.

Nga verifikimi administrativ i kryer nga Komisioneri, rezultoi se punonjësi ***** me aktin nr. 7794, datë 09.12.2016, të Departamentit të Administratës Publike është emëruar nëpunës civil në pozicionin “Drejtor në Drejtorinë e Inspektimit Financiar Publik”, në Ministrinë e Financave. Më pas, në zbatim të urdhrit nr. 131, datë 05.10.2017, të

Kryeministrit, *“Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë”*, nëpunësi në fjalë, me aktin nr. 6846/4 prot., datë 04.12.2017, të njësisë përgjegjëse, për shkak të ristrukturimit është transferuar në mënyrë të përhershme në pozicionin *“Drejtor në Drejtorinë e Inspektimit Financiar”*, në Drejtorinë e Përgjithshme Rregullatore dhe Përputhshmërisë, në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë.

Në zbatim të nenit 48, pika 1, germa a), të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar, me aktin nr. 4340/1 prot., datë 18.07.2019, të DAP, është vendosur transferimi i nëpunësit ***** në pozicionin *“Drejtor i Drejtorisë AFMIS”*, në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, kategoria e pagës II-b. Transferimi i përkohshëm i këtij nëpunësi për periudhën 6 mujore, është kryer për interes të institucionit, i cili materializohet me shkresën nr. 13553 prot., datë 16.07.2019, të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, *“Kërkesë për transferim të përkohshëm”*.

Në përfundim të afatit të transferimit të përkohshëm, nëpunësi ***** me shkresën e datës 31.01.2020, ka kërkuar prej njësisë përgjegjëse (DAP), rikthimin në pozicionin e mëparshëm të punës, e cila me aktin nr. 4340/3 prot., datë 14.02.2020, ka vendosur rikthimin e këtij nëpunësi në pozicionin *“Drejtor në Drejtorinë e Inspektimit Financiar”*, duke njoftuar për zbatimin e këtij akti administrativ institucionin përkatës.

Nga aktet e administruara në kuadër të hetimit administrativ, konstatohet që Drejtori i Përgjithshëm i Ekonomisë dhe Shërbimeve Mbështetëse, të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, me shkresën nr. 3656 prot., datë 18.02.2020, në zbatim të urdhrin nr. 126 prot., datë 09.04.2019, të Ministrit, *“Për ngritjen e grupit të punës për kryerjen e analizës lidhur me organizimin e brendshëm të aparatit të Ministrisë dhe nevojën e ndryshimit të strukturës dhe organikës”*, ka marrë masat për fillimin e procedurës së ristrukturimit të ministrisë.

Bazuar në aktet e mësipërme, Sekretari i Përgjithshëm i ministrisë, me shkresën nr.2750/2 prot., datë 25.02.2020, ka njoftuar Departamentin e Administratës Publike dhe kërkuesin ***** se institucioni nuk mund të procedojë me rikthimin e këtij nëpunësi në pozicionin e mëparshëm, deri në përfundim të procedurës së ristrukturimit.

Duke analizuar gjithë sa u parashtrua më sipër, ku përfshihen pretendimet e ankuesit, dokumentacioni i dërguar nga Departamenti i Administratës Publike dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil arrin në përfundimin se, njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore pranë ministrisë ka vepruar në kundërshtim me përcaktimet e nenit 48 dhe 50, të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, të ndryshuar, duke mos plotësuar detyrimin për kthimin e nëpunësit ***** në pozicionin e mëparshëm të punës, në përfundim të periudhës së transferimit të përkohshëm.

Në nenin 48, pika 1, germa a), të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, përcaktohet shprehimisht se, nëpunësi civil mund të transferohet, përkohësisht, në një pozicion tjetër, të së njëjtës kategori, në interes të institucionit, deri në 6 muaj gjatë 2 viteve. Në rastin konkret, rezulton se nëpunësi ******, është transferuar për interes të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, në një pozicion të shërbimit civil të të njëjtës kategori, brenda të njëjtit institucion.

Më tej, në pikën 4, të këtij neni përcaktohet se, në përfundim të afatit të transferimit, nëpunësi civil kthehet në pozicionin e mëparshëm. Në zbatim të Kreut I, pika 12, të vendimit nr. 125, datë 17.02.2016, të Këshillit të Ministrave, “Për transferimin e përkohshëm dhe të përhershëm të nëpunësve civilë”, kthimi në vendin e punës bëhet nga njësia përgjegjëse, pas mbarimit të afateve të parashikuara në vendimin e saj dhe jo më vonë se afatet e parashikuara në pikën 2, të këtij vendimi.

Në lidhje me sa më sipër, rezulton se, njësia përgjegjëse (DAP), kundrejt përcaktimeve të mësipërme ligjore ka nxjerrë aktin administrativ nr. 4340/3 prot., datë 14.02.2020, duke urdhëruar kthimin e nëpunësit ****** në pozicionin “Drejtor në Drejtorinë e Inspektimit Financiar”, ku rezulton të ketë emërimin e përhershëm.

Pretendimi i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, se nuk mund të vijojë me rikthimin e nëpunësit në pozicionin “Drejtor në Drejtorinë e Inspektimit Financiar, në Drejtorinë e Përgjithshme Rregullatore dhe Përputhshmërisë”, për shkak të ristrukturimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, nuk është i bazuar në ligj.

Në nenin 50, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe Kreun II, të vendimit nr. 125, datë 17.02.2016, të Këshillit të Ministrave, “Për transferimin e përkohshëm dhe të përhershëm të nëpunësve civilë”, nuk parashikohet ndonjë kusht që të pezullojë veprimin e institucionit për rikthimin e nëpunësit civil në pozicionin e tij të mëparshëm, në përfundim të afatit të transferimit të përkohshëm.

Në kuptim të Kreut II, pika 18, të aktit nënligjor të sipërcituar, Komisioni i Ristrukturimit bazon vendimmarrjen e tij në kriteret specifike të pozicioneve të lira të krijuara të reja apo të ristrukturuara dhe në të dhënat e nëpunësve civilë, vendet e të cilëve preken si pasojë e ristrukturimit, gjithmonë duke u nisur nga pozicioni i momentit, ku nëpunësi ka emërimin e përhershëm.

Në Udhëzimin nr. 1, datë 01.03.2016, të Departamentit të Administratës Publike, “Për krijimin, funksionimin dhe kompetencat e Komisionit të Ristrukturimit për shkak të mbylljes apo ristrukturimit të institucionit” i ndryshuar, përcaktohen në mënyrë të detajuar hapat që duhet të ndjekë Komisioni i Ristrukturimit, si më poshtë:

- Krahason strukturën e re me strukturën ekzistuese, duke evidentuar pozicionet që preken nga ristrukturimi, ato që krijohen rishtaz si dhe ato që suprimohen;
- Verifikon përshkrimet e punës për të evidentuar kriteret e veçanta për secilin pozicion dhe përgatit listat me grupet e pozicioneve bazuar në kriteret e veçanta;
- Verifikon dosjen personale të nëpunësve, pozicionet e të cilëve preken nga procesi i ristrukturimit, me qëllim vlerësimin e arsimit, përvojës në pozicionin ku ushtron detyrën, e tjera.

Nga analiza e dispozitave të mësipërme ligjore, arrihet në konkluzionin, se zbatimi i rregullave të ristrukturimit, duhet të realizohet duke marrë për bazë pozicionet ku nëpunësit civilë kanë emërimin e rregullt, (*me procedurë konkurrimi, emërim pas transferimit të përhershëm, për shkak ristrukturimi, etj.*) dhe jo mbi bazën e pozicioneve, ku ata për arsye të ndryshme, punojnë në mënyrë të përkohëshme, në momentin që fillon procesi i ristrukturimit.

Për këtë arsye, Komisioneri e vlerëson të bazuar në ligj veprimin e njësisë përgjegjëse për nxjerrjen e aktit administrativ për rikthimin e nëpunësit *****, në pozicionin e mëparshëm, pas përfundimit të periudhës 6 mujore të transferimit të përkohshëm, duke çmuar në të njëjtën kohë të padrejtë mosveprimin e saj, për realizimin e atributit të përcaktuar në nenin 7, pika 1, germa c) dhe f), të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, sipas të cilës, Departamenti i Administratës Publike ka detyrimin që të mbikëqyrë zbatimin e legjislacionit të shërbimit civil në institucionet e administratës shtetërore, duke i mbështetur ato dhe siguruar këshillimin e drejtimin e nevojshëm, çka duhet të shoqërohet edhe me kryerjen e veprimeve të tjera aktive, për zbatimin e akteve të saj, me qëllim që të vihen në vend të drejtat e nëpunësve.

Kjo për faktin se, në përmbajtje të shkresës së njësisë përgjegjëse nr. 1941/1 prot., datë 14.05.2020, “Kthim përgjigje suajës nr. 243/1 prot., datë 30.04.2020”, drejtuar Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, konstatohet se njësia përgjegjëse ka urdhëruar fillimisht për respektimin e të drejtës së nëpunësit, duke e rikthyer në vendin e mëparshëm të punës, pas përfundimit të transferimit të përkohshëm, por më pas ka heshtur dhe nuk ka mbajtur qëndrim ndaj pretendimeve dhe arsyetimeve të pabazuara të institucionit të përfshirë në këtë mosmarrëveshje.

Në vijim të trajtimit të mëtejshëm të rastit në fjalë, konstatohet që procesi i ristrukturimit të institucionit nuk ka avancuar përtej fazës së ngritjes të grupit të punës për ristrukturimin dhe nuk ekziston ndonjë dokument tjetër që të provojë se ky institucion ka filluar realisht procedurën e ristrukturimit në përputhje me përcaktimet e nenit 50, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar. Siç u tha dhe më lart, ekziston vetëm akti nr. 126 prot.,

datë 09.04.2019, i Ministrit të Financave dhe Ekonomisë, “Për ngritjen e grupit të punës për kryerjen e analizës lidhur me organizimin e brendshëm të aparatit të Ministrisë dhe nevojën e ndryshimit të strukturës dhe organikës”, i cili është hapi fillestar për nisjen e procesit të ristrukturimit dhe aktualisht, megjithëse ka kaluar më shumë se një vit, nuk rezulton të jenë hedhur hapa të tjerë drejt realizimit të tij.

Kjo do të thotë se shkak i paraqitur si argument për moszbatimin e aktit të njësisë përgjegjëse për kthimin e nëpunësit ***** në pozicionin e tij të punës ku ka emërimin e përhershëm, nuk është i arsyeshëm dhe i bazuar në ligj. Në këto kushte, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, duhet të marrë masa të menjëhershme për zbatimin e aktit nr.4340/3 prot., datë 14.02.2020, të Departamentit të Administratës Publike, duke vendosur rikthimin e këtij nëpunësi në pozicionin “Drejtor në Drejtorinë e Inspektimit Financiar, në Drejtorinë e Përgjithshme Rregullatore dhe Përputhshmërisë”, në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë e pas kësaj mund të vazhdojë të procedojë në procesin e ristrukturimit, sipas kushteve konkrete.

Për këto arsye:

Në mbështetje të kompetencës së përcaktuar në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, në ligjin nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, si dhe në nenet 16, 34 dhe 35, të Rregullores, “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

VENDOSA:

1. Departamenti i Administratës Publike, të drejtojë procesin për ekzekutimin e aktit të tij nr. 4340/3 prot., datë 14.02.2020, “Njoftim”, i nxjerrë në cilësinë e njësisë përgjegjëse, deri në vendosjen përfundimtare të ligjshmërisë.
2. Njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, të rikthejë nëpunësin ***** në pozicionin e tij të mëparshëm “Drejtor në Drejtorinë e Inspektimit Financiar, në Drejtorinë e Përgjithshme Rregullatore dhe Përputhshmërisë”, në përfundim të periudhës së transferimit të përkohshëm, duke vendosur fillimin e marrëdhënies së punës dhe asaj financiare për këtë pozicion, ashtu siç ka urdhëruar njësia përgjegjëse.
3. Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe njësia përgjegjëse (DAP), të zbatojnë vendimin brenda 15 ditëve nga data e marrjes dijeni, dhe pas përfundimit të këtij afati, të njoftojë me shkrim Komisionerin për zbatimin e vendimit.

4. Në rast të moszbatimit të këtij vendimi paralajmërues, Komisioneri do të vijojë procesin për rregullimin e shkeljeve të konstatuara, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, duke përdorur mjetet ligjore për të rikthyer ligjshmërinë në administrimin e shërbimit civil, nëpërmjet gjositjes së nëpunësit përgjegjës për mos zbatimin e masave të përcaktuara në dispozitivin e vendimit.
5. Të njoftohen për këtë vendim paralajmërues, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Departamenti i Administratës Publike dhe nëpunësi *****.
6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera Strakosha